**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**
**Zyra e Komisionerit**

---

Nr. 342/4 Prot                                                                 Tiranë,më 18.01 /2013

**Lenda :** Dërgohet regjistri mbi realizimin e prokurimeve publike për vitin 2012.

**Drejtuar :** Agjencisë së Prokurimit Publik

**TIRANE**

Në mbeshtetje të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik",i ndryshuar, V.K.M. nr,1 datë 10.01.2007"Për miratimin e rregullave të prokurimit ",i ndryshuar, Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ",Ligjit nr,10487 datë 05/12/2011."Për buxhetin e vitit 2012", Udhëzimit nr.2,datë 6/02/2012"Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"Udhëzimit nr,2/1 datë 15/02/2012,"Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012"", ju paraqesim sipas formatit të caktuar të Agjencisë së Prokurimit Publik si dhe në menyrë elektronike, informacionin e detajuar të realizimit të prokurimeve publike për vitin 2012.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin:

**KOMISIONERI**

**Konc:**L.Xhaka

**Sigloi:**L.Morina

**FLORA ÇABEJ(POGAÇE )**

Rr "Abdi Toptani", Kati i II-të, Nr.4, Tiranë, Tel: + 355 42 237 200

Web-site: www.kmdp.al, Fax: +355 4 2233977

# REGJISTRI I REALIZIMIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE

**INSTITUCIONI QENDROR:** KOMISIONERI PER MBROJTJEN E TE DHENAVE PERSONALE

**Enti Prokurues:** KOMISIONERI PER MBROJTJEN E TE DHENAVE PERSONALE

**12/mujori 2012**

| Nr. | Objekti i prokurimit | Fondi limit i parashikuar | | Vlera e prokuruar | | Proçedura e prokurimit | Firma fituese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Investime | Shpenzime | Investime | Shpenzime | | |
| | | | | | | | |
| 1 | **Detyrime nga viti 2011** | | **292500** | | 292500 | detyrime te vititt 2011 | |
| 2 | Kanceleri | | 480,000 | | 479,090 | blerje me vlerë të vogë | New Ofiice Alnbania,Alfa Supplies |
| 3 | Materiale per funk pajisjeve zyres | | 400,000 | | 399500 | blerje me vlerë të vogë | Aulivia shpk |
| 4 | Materiale pastrimi e ndricimi | | 100,000 | | 109,635 | blerje me vlerë të vogë | Impuls shpk,Shpiragu,Ite |
| 5 | Blerje dokumentacioni | | 2,600 | | 2,600 | blerje me vlerë të vogë | Ylli Zgjani , |
| 6 | Furniz e materiale pergji | | 100,000 | | 109,796 | blerje me vlerë të vogë | Copier Computer center |
| 7 | Libra e publikime ( abonime) | | 225,000 | | 225,840 | blerje me vlerë të vogë | Agjensia e Abonim. te shtyp |
| 8 | Libra profesionale | | 85,000 | | 83,300 | blerje me vlerë të vogë | Adrion |
| 9 | Elektri, uje , sherb telefonike | | 1,800,000 | | 1,745,625 | blerje me vlerë të vogë | me kontrate sherbimi |
| 10 | Sherbime i mirembajtje faqe dhe prog buxheti | | 155,000 | | 155,600 | blerje me vlerë të vogë | Instituti I M. ne Biznes ,ARK-IT |
| 11 | Prodhim dokumentacioni specifik | | 450,000 | | 435,000 | blerje me vlerë të vogë | APA |
| 12 | Roje sigurimi ndertese | | 470,000 | | 463,680 | blerje me vlerë të vogë | Ales shpk, |
| 13 | sherbime bankare | | 9,900 | | 12,800 | blerje me vlerë të vogël | |
| 14 | Sherbime te promocionit | | 480,000 | | 477,374 | blerje me vlerë të vogë | APA partners ,Alflexim |
| 15 | Sherbime te tjera,publikim gazeta etj | | 550,000 | | 552,460 | blerje me vlerë të vogë | Panorama,Shekulli.com,Media |
| 16 | Karburant | | 150,000 | | 185,000 | blerje me vlerë të vogë | skenderi G |
| 17 | Riparim automjetesh | | 100,000 | | | blerje me vlerë të vogël | |
| 18 | Pjese kembimi | | | | | blerje me vlerë të vogël | |
| 19 | Siguracion mjetesh | | | | | blerje me vlerë të vogël | |
| 20 | Shpenzime te jera transporti | | | | | blerje me vlerë të vogël | |
| 21 | Shpenzime udhetimi jashte vendit | | 2,600,000 | | 2,602,055 | blerje me vlerë të vogë | Amadeus travel,etj +dieta |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 22 | Shpenzime udhetimi brenda vendit | | 570,000 | | 488,660 | blerje me vlerë të vogël | |
| 23 | Sherbime mirembajtje | | 60,000 | | 71,500 | blerje me vlerë të vogël | Bizn. I vogel, |
| 24 | Shpenzime qiramarrje ambjentesh | | 121,000 | | 121,700 | blerje me vlerë të vogël | Hanxhari,Eral,Llakitrans |
| 25 | Shpenzime qiramarrje per mjete trans e aparat | | | | | blerje me vlerë të vogël | |
| 26 | Shpenzime pritje percjellje | | 38,200 | | 12,000 | blerje me vlerë të vogël | |
| 27 | Shpenzime honorare | | 26,000 | | 26,000 | blerje me vlerë të vogël | |
| 28 | Shpenz per pjesem ne konferenca | | | | | blerje me vlerë të vogël | |
| 29 | Materiale e e sherbime operative | | 45,000 | | 45,000 | blerje me vlerë të vogël | Uldedaj |
| 30 | Blerje orendi e pajisje zyrash | 520,000 | | 517,800 | | blerje me vlerë të vogël | Person fizik A.Gjanaj,Neptun,Auliv |
| 31 | Blerje pajisje kompjuterike | 480,000 | | 474,000 | | blerje me vlerë të vogël | Sinteza |
| 33 | Permiresim sistemi dhe shtim module | 2,000,000 | | 979,998 | | Tender (kerkese me propozim) | |
| | | | | | | blerje me vlerë të vogël | |
| | | | | | | blerje me vlerë të vogël | |
| | | **3,000,000** | **9,310,200** | **1,971,798** | **9,096,715** | blerje me vlerë të vogël | |
| | | | | | | blerje me vlerë të vogël | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |

**DREJTORI I SHERBIMEVE**
**Lindita Morina**

**JURISTE**
**Elka Dafa**

**Financiere**
**Lindita Xhaka**

**Specialist IT**
**Neritan Sulaj**

**Miratoi**

**Flora Cabej**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONERI PER MBROJTJEN E TE DHENAVE PERSONALE
TIRANE

**Lënda:** Mbi Performancen Financiare Buxhetore të KMDP-se dhe realizimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2012.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale , në zbatimin të buxhetit të vitit 2012, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *"Për mbrojtjen e te dhenave personale"*.

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në lidhje me performancen financiare buxhetore , ka vepruar me korrektesi në zbatim të Ligjit nr,10487 datë 05/12/2011"Për buxhetin e vitit 2012", udhëzimit nr,2 datë 06/02/2012,"Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012',

Ne mbeshtetje te Ligjit nr. 10487 datë 05/12/2011"Për buxhetin e vitit 2012",i ndryshuar për vitin 2012, është miratuar për Komisionerin për Mbrojtjen e te Dhenave personale « programi » buxhetor :

- Programi me emërtimin « Planifikim, menaxhim dhe administrim » ku përfshihet i gjithe buxheti i akorduar për funksionimin e aktivitetit të Zyrës se Komisionerit për Mbrojtjen e te Dhenave Personale

**Programi "Planifikim, Menaxhim dhe Administrim"**

Buxheti i akorduar per kete program ka ne baze te tij Deklaraten e Politikes (DPP) se hartuar gjate procesit te PBA 2011-2014. Ky buxhet eshte ne funksion te realizimit te politikes se percaktuar ne DPP: Mbeshtetja, organizimi, krijimi i kushteve te nevojshme per mirefunksionimin e KMDP, perafrimin e harmonizimi legjislacionit ne fushen e te dhenave personale me legjislacionin e vendeve te tjera te komunitetit evropian, me te drejten komunitare si dhe privatesine,imponimi i legjislacionit te sotem ekzistues vendas si dhe ndergjegjesimin dhe shtrirjen e fushes se zbatimit te ligjit ne te gjithe vendin duke garantuar nje transparence totale te përpunimit dhe garantimit te te dhenave , siguri maksimale te te dhenave personale ,intensifikimi i mareveshjeve me strukturat e BE duke garantuar maksimalisht mbrojtjen e te dhenave personale te shtetasve ne levizje ose rezident ne BE. administrimi e menaxhimi i regjistrit elektronik dhe fizik te subjekteve kontrollues, monitorimin, rekomandimin dhe investigimet ne kuadrin e mbrojtjes se te dhenave personale,mbi te cilat KMDP zhvillon pergjegjesite e saj ligjore, per te garantuar maksimalisht te drejtat dhe lirite themelore te njeriut .

Rr "Abdi Toptani", Kati i II-të, Nr.4, Tiranë
E-mail: ëëë.kmdp.al
Tel: + 355 42 2 237200

Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave personale , në mbeshtetje të ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006"Për prokurimin Publik" , me ndryshimet, V.K.M nr..1,datë 10.01.2007,"Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik",ndryshuar si dhe në bazë dhe për zbatim të regjstrit të parashikimeve të vitit 2011, për periudhen 8-mujore ka prokuruar

I- ***Fondi per shpenzim investime** (zeri 231) , nga vlera e pergjithshme prej 3,000 (ne mije leke) per vitin 2012 , ka prokuruar fondin e vene ne dispozicion per tre projektet e alokuara nga ministria e Financave*

KMDP, ne kete drejtim, ne zbatim te dispozitave ligjore financiare ne fuqi dhe te Regjistrit te Parashikimeve te Prokurimeve Publike te vitit 2012, ka prokuruar fondet per investime sipas projekteve

Gjate vitit , nje nga detyrat parësore dhe prioritare ka qenë ndjekja e realizimit të procedurave të prokurimeve në mbështetje të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik",i ndryshuar, udhëzimit nr.2 "Për procedurën e blerjeve të vogla",mbi bazën e kërkesave dhe fondeve të alokuara sipas projekteve të miratuara për investime e konkretisht jane realizuar investimet e mëposhtme.

- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave "**Blerje e pajisjeve kompjuterike – server** ",per plotësimin e kushteve optimale në ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhenave të krijuara në insitutcion si ato financiara ashtu edhe dokumentare. .Fondi i alokuar nga Ministria e Financave ka qenë në masën 480 në mije lekë dhe realizuar me proceduren me blerje të vogel ne masen 474( në mijë lekë ).

- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave "**Blerja dhe instalimi e kartës së sekretarisë telefonike**" një shtese e projektit të realizuar në vitin 2011 –instalim i centralit të brendshëm telefonik" i cili mundësoi komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm nëpërmjet pritjes dhe transferimit automatik të thirrjeve si dhe monitorimin në mënyrë të detajuar të telefonatave në kohë dhe impulse ,me anë të së ciles u krijua mundësia e përdorimit me efektivitet të shpenzimeve telefonike drejt minimizimit të shpenzimeve konkrete.
  Fondi i alokuar nga Ministria e Financave ne Projektin M890001 (520 ) në mije lekë është realizuar me procedurën blerje e vogël, pranë Firmës Global Net në shumën 70 (në mje lekë) .

- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave "**Blerje mobilje për zyrat** "u realizua kompletimi i sallës së mbledhjeve dhe trajnimeve me mobilje të domosdoshme për zhvillimin e trajnimeve dhe pritjeve të kontrolluesve vendas si dhe delegacioneve të huaja.pajisje pritje përcjellje etjpajisje zyre Fondi i alokuar nga Ministria e Financave ka qënë në masën 520 në mijë lekë, në projektin M890001 dhe eshte realizuar ne shumen 447 në mije lekë me proceduren "Blerje e Vogel"

Për pojektin me objekt prokurimi "Intranet" alokuar nga Ministria e Financave në vlerën 2.000 (ne mije leke) jane ndjekur procedurat e tenderimit me proceduren "**Kerkese me propozim** " e pas deshtimit të procedurës së parë, u ndoq edhe një herë procedura dhe u shpall fitues Firma fituese MC Networking shpk në shumen 979 në mije leke ,me TVSH, sipas kontratës së lidhur me nr 1201/5 me kohezgjatje prej nje periudhe 5-mujore. Fondi i vene në dispozicion ka qenë 2.000 ne mije leke dhe pas shpalljes se njoftimit te fituesit dhe lidhjes së kontratës, implemntimit dhe marrjes në dorëzim të sistemit , u krye pagesa sipas referncës së kontratës ,ku kemi një kursim të fondeve të alokuara dhe për pasoje ky fond derdhet në buxhet,

Sa i perket realizimit ne % edhe pse është proktuar gjithe fondi % e realizimit në total për investimet del në parametra të ulet 65 %, pasi pjesa e mbetur nuk raportohet si pagesë.
Plani 3.000 ( në mije ) leke
Realizmi 1.971 ( ne mije ) leke
Realizimi ne % 65 %

***II-*** ***Fondi per shpenzim Operative*** *(zeri 602) , nga vlera e pergjithshme prej 9310 (ne mije leke)me ndryshimet perkatese te realizuar deri ne periudhen qe raportohet eshte prokuruar dhe realizuar ne masen 9.096 ne mije leke ose 98 % e fondit te planifikuar vjetor. duke respektuar kerkesat e detajuara ne Regjistrin e Prokurimeve Publike, te miratuara edhe nga Agjensia e Prokurimeve Publike.*

Regjstri i prokurimeve , është realizuar në permbushje te objektivave dhe strategjise se miratuar per komisionerin per Mbrojtjen e te Dhenave personale per vitin 2012. e ndare ne produktet qe do te realohen me fondet e alokuara nga ministria e Financave e konkretisht

- Persa i perket **produktit Mbeshtetja me burime njerezore dhe financiare** ,ne realizimin e tij te shprehur ne vlere jane perfshire sigurimi i sherbimeve te pergjithshme per te gjithe personelin , si furnizimi me uje, drita , telefon, sherbime sigurimi, sherbime abonimi per gjithe stafin si dhe furnizimi me mallra e sherbime te mbarevajtjes se punes se perditshme,kanceleri ,sherbime mirembajtje programi ,pjesemarrje dhe perfaqesime e pjesemarrje ne aktivitete nderkombetare .

Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale , ka zbatuar me korrektesi te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Ligji per mbrojtjen e te Dhenave personale te, si dhe legjislacionin admnistrativo-financiar shqiptar.

- "Mallra te natyrave te ndryshme" te cilat per kete periudhe jane prokuruar me proceduren e blerjeve te vogla sipas nevojave te institucionit,ne zerat dhe sherbimet e sipermendura zene Shumen 4.249 ne mije leke .